

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“Blue IQ”

**Neni 1  
Emri**

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**Blue IQ**” Sh.p.k, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”.

**Neni 2  
Themelimi**

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare” të ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe këtë Akt Themelimi.

**Neni 3  
Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: **Ruga “Qafhardhi”, Lagjja “Daniel Matlia” nr pasurie 11.118, zona kadestrale 8594, Shkoder.**

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 4  
Ortakët e Shoqërisë**

4.1 Ortaku i vetem dhe themeluesi i Shoqërisë eshte:

- (a) **Znj. Suela Durraj** shtetase Shqiptare lindur në **Pogradec** më **06/07/1973** i pajisur me letërnjoftim/pasaportë nr. **H35706174H**, me adresë: **Rr. Memej, Shkoder**, zotëruese e një kuote kundrejt kontributit prej **100,00 leke**, që përfaqëson **100 %** të kapitalit të Shoqërisë

**Neni 5  
Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100,(njeqind) leke. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij te me poshtem:



- ~ Ortaku themelues **Znj. Suela Durraj**, zotëruese e një kuote me vlerë te per gjithshme **100,00 leke**, që përfaqëson **100 %** të kapitalit të Shoqërisë

5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontributet në para dhe zotërohet nga ortaku i vetem i Shoqerise.

5.3 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjeter dhe forme të parashikuar nga ligji.

#### **Neni 6 Objekti**

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:

- ~ Punime qeramike dhe hisdrosanitare e elektrike, punime hidrotermoizoluese, punime duralumini e punime pllaka, e gipsi etj. Realizimn e puneve te ndermjetesimit, agjencise dhe transportit ne interes te vete te shoqerise dhe te paleve te treta porositese. Punime te ndertimit si muratura, suvatime, nivelime, shtrim pllakash, instalim dhe shtrim parketi, si dhe punime te ndryshme ndertimi. Cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ne funksion te qellimeve te mesiperme Shoqeria mund te hyje ne tregje dhe operacione te ndryshme, te zoteroje pasuri te luajtshme e te paluajtshme dhe/ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera tregtare

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 7 Kohëzgjatja**

7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 8 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

8.1 Asambleja e Përgjithshme, në perputhje me ligjet shqiptare, mund të marre, por pa u kufizuar, vetem ne, vendime per ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, emerimin e ekspertit kontabel, miratimin e llogarive vjetore dhe te pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

#### **Neni 9 Administrimi i Shoqërisë**



9.1 Administratori/ët e parë të Shoqërisë janë: Znj. Suela Durraj shtetase Shqiptare, lindur ne Pogradec më 06.07.1973 e pajisur me letërnjoftim/pasaportë nr. H35706174H, me adresë: Rr. Memej, Shkoder

9.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorët shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

9.3. Administratorët e parë të Shoqërisë do të veprojnë bashkarisht në marrjen e vendimeve dhe akteve të parashikuara në ligj dhe statutin e Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Ligji i Zbatueshëm**

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar, sot më datë 31.08.2022

**Ortaku themelues**

Znj.Suela Durraj

SUELA DURRAJ

